

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"BALLKAN FOODS" shpk**

Sot, më 22.01.2021, unë, themeluesi, Enis Haliti, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me numër ID1676055, me numër personal 1170862712, i datëlindjes 22.09.1986, lindur në Podujevë, Kosovë dhe banues në Prishtinë, Kosovë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është: "BALLKAN FOODS" shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - a) Tregtimin e artikujve ushqimorë: tregtimin me shumicë dhe pakicë të produkteve të ndryshme ushqimorë, duke përfshirë por pa u kufizuar; produkte të salcave, erëzave, produkte që qumështit, vezëve, vajrave, yndyrave të gatimit, drithërave, duhanit, farërave e ushqimit për kafshë, kafes, çajit, kakaos dhe produkte të tjera të ngjashme.
  - b) Tregtimin e artikujve të ndryshëm të konsumit: tregtimin me shumicë dhe pakicë të çdo produkti konsumi apo përdorimi shtëpiak, duke përfshirë por pa u kufizuar; produkte të pastrimit, kujdesit, produkte shtëpiake, të tekstileve, aktivitete të ambalazhimit, veshje, këpucë, dhe produkte të tjera të ngjashme.
  - c) Importimin dhe eksportimin e artikujve ushqimorë, artikujve të tjerë të konsumit dhe pajisje të tjera në funksion të aktivitetit: importe mallra ushqimorë, lëndë të para, produkte të gatshme dhe gjysmë të gatshme, artikuj të tjerë konsumi, import të pajisjeve të ndryshme, pajisje të magazinimit, ruajtjes, staxhionimit, dhe çdo mall apo shërbim i nevojshëm të ciklit të jetës së produktit.
  - d) Ofrimin e shërbimit të ruajtjes, shpërndarjes, magazinimit të artikujve të tregëtueshëm, përzjerjen, përpunimin e nevojshëm dhe aktivitete të tjera të ngjashme.
- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga e "Elbasanit", Pallati Fratari, Shkalla 1, Kati 6, Apartamenti 27, Tiranë.

- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5**  
**Kapitali fillestar i shoqërisë**

- 1) Kapitali fillestar i shoqërisë është 120,000 (Një qind njëzet mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortakut Enis Haliti.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**  
**Administratori**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Enis Haliti, atësia Shemsi, shtetas Kosovar, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me numër ID1676055, me numër personal 1170862712, i datëlindjes 22.09.1986, lindur në Podujevë, Kosovë dhe banues në Prishtinë, Kosovë; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve kompetente të njohura nga ligji.

\*\*\*

**ORTAK I VETËM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"BALLKAN FOODS" shpk**

  
\_\_\_\_\_

**Enis Haliti**

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

ENIS HALITI